

Këshilla për prindërit që të motivojnë fëmijët e tyre

Tregoni rregullisht interesim

Tregoni interes për mbarëvajtjen në shkollë të fëmijës suaj, për vështirësitë dhe sukseset që ka.

P.sh. këtë mund ta bëni këtë duke i treguar dhe shpjeguar detyrat e shtëpisë, duke e lënë atë të tregojë për ditën në shkollë, duke e dëgjuar me vëmendje, duke shprehur mirëkuptim për situatën dhe duke reaguar në rast të një problemi.

Lëreni fëmijën të shpjegojë se pse nuk i pëlqen të bëjë disa detyra shtëpie, pse ka "frikë" nga një lëndë dhe pse nuk shkon (thjesht) mirë me një shok apo shoqe klase ose me mësuesit.

Inkurajoni bisedat

Lëreni fëmijën tuaj të ndiejë se ju si prind i qëndroni pranë, edhe nëse ai vepron gabim ose merr një notë të keqe. Nxiteni fëmijën të flasë për situata të vështira në shkollë për të gjetur bashkërisht një zgjidhje.

Vlerësojeni fëmijën

Fillimisht vlerësojeni fëmijën tuaj për përpjekjet në një lëndë dhe më pas për rezultatin, p.sh. për notën (pa ekzagjerim).

Vlerësim mund të jetë: "Sa mirë që i ke bërë detyrat e shtëpisë edhe pse për momentin matematika nuk po të tërheq aq shumë" ose "Shkrimi yt tregon që ke bërë goxha përpjekje".

Vlerësimi mund të shprehet me fjalë, por edhe me një buzëqeshje, një miratim me tundjen e kokës, me një përqafim.

Mos e vlerësoni fëmijën tuaj me një kushtëzim mëvonshëm si p.sh.: "3-shin që more në diktim është një përmirësim domethënës, por me pak më shumë përpjekje mund të kishe marrë edhe një 2-sh."

Mendoni me kujdes se kur dhe si i përdorni shpërblimet për të konstatuar arritjet. Është për t'u theksuar thënia në vijim: Të bësh diçka së bashku vlen më shumë se ëmbëlsirat apo dhuratat me para.

Fëmija bindet më lehtë me anën e vlerësimeve sesa qortimeve apo ndëshkimeve. Vlerësimi e nxit dhe e forcon fëmijën tuaj.

Pranimi i anëve të forta dhe të dobëta

Çdo fëmijë ka ritmin e tij të të mësuarit. Me pritshmëritë e larta që keni e mbingarkoni fëmijën tuaj, p.sh. kur e pyesni "Akoma nuk e ke mësuar vjershën?". Mos prisni nga fëmija më tepër nga ç'mund të japë.

Bëni kujdes me fjalitë "Mblidh mendjen" ose "Duhet të mësosh më shumë, sepse ta kalojnë të tjerët". Kështu i bëni presion fëmijës. Nxiteni fëmijën përmes vëmendjes dhe besimit që të vazhdojë përpjekjet: "Jam i sigurt që mund t'ia dalësh".

Mundohuni t'i tregoni fëmijës suaj suksese të vogla që i ka arritur vetë: "Shiko sa ke përparuar".

Inkurajojeni fëmijën të marrë pjesë në aktivitete të kohës së lirë që janë të përshtatshme për moshën

Këtu përfshihen ushtrimet në ambientet brenda dhe jashtë (p.sh. lojërat dhe aktivizimi me shoqërinë, kërcimi), sportet individuale ose në skuadër (p.sh. në një grup të lirë në "natyrë" ose në një klub), aktivitetet në shtëpi (p.sh. punime dore ose lexim), të kënduarit, të bërit muzikë, ...

Motivoheni fëmijën të mos dorëzohet nëse e ka humbur interesin apo kur has vështirësi, por mos e detyroni vazhdimisht të bëjë diçka që nuk i pëlqen.

Fëmija juaj duhet të marrë kënaqësi nga aktivitetet dhe të jetë i sigurt tek aftësitë e tij, sepse vetëm atëherë mund të ketë sukses.

Mësojeni fëmijën të jetë i pavarur

Sa më i pavarur të jetë një fëmijë në jetën e përditshme, aq më e lehtë e ka që të punojë i pavarur në shkollë.

Ngarkojini fëmijës që herët detyra të vogla në shtëpi ose kur bëni pazar, në mënyrë që të mësohet me përgjegjësinë dhe të veprojë në mënyrë të pavarur. Vlerësojeni fëmijën për performancën e pavarur.

Të mësuarit në mënyrë të pavarur përbën sot një qëllim themelor të arsimimit. Shkolla përdor metoda mësimdhënieje për një të mësuar të pavarur që përshtatet me moshën dhe jep një shpjegim të hollësishëm. Pyesni mësuesit e fëmijës sesi duket kjo në nivel klase dhe sesi mund ta ndihmoni në shtëpi me përpjekjet e tij.

Udhëzim: Kjo temë përshtatet mjaft mirë edhe për mbledhjen e prindërve (takimi për kujdestarinë e klasës), ngaqë prindërit mbledhen të gjithë në një klasë.

Shikoni nëse fëmija juaj vëren gabime në detyrat e shtëpisë. Nëse arrin t'i kuptojë, vlerësojeni që i zbuloi vetë. Kur nuk i dallon gabimet, nxiteni t'i hedhë një sy edhe një herë.

Bëni kujdes nga pafuqia për të mësuar! Për t'u tërhequr më shumë vëmendje prindërve, fëmijët priren ta marrin këtë vëmendje me anën e ndihmës me detyrat e shtëpisë. Vihet re se sa më negativ të jetë sukcesi në të mësuar, aq më shumë ndihmojnë prindërit me detyrat. Prandaj, nxiteni fëmijën që të përpiqet t'i bëjë vetë detyrat. Si shpërblim dhe për t'i tërhequr vëmendjen, për shembull, mund t'i ofroni fëmijës tuaj një aktivitet të përbashkët lojërash ose mund të ndërmerrni diçka të vogël bashkërisht.

Kur jeni të pasigurt se si mund ta ndihmoni fëmijën me detyrat, veçanërisht kur nuk e njihni mirë gjermanishten, pyesni mësuesit përkatës. Pyesni se çfarë sugjerimi japin për detyrat dhe gjeni bashkërisht mundësi konkrete dhe praktike.

Edukojeni fëmijën të organizojë kohën dhe përgjegjësitë e tij

Aktivitetet dhe rutinat e përsëritura në mënyrë të qëndrueshme janë të rëndësishme në jetën e përditshme, sepse ofrojnë strukturë dhe si rrjedhojë edhe siguri.

Fëmijët pëlqejnë rutinat, sepse u vjen mirë. Rutinat mund të jenë: gjithmonë e njëjta rutinë në mëngjes para shkollës, ngrënia së bashku, detyrat e shtëpisë, oraret fikse (të leximit) dhe lojërat, sportet ose mësimet e muzikës, kohët e lutjes dhe reflektimit, bisedat familjare, udhëtimet dhe vizitat, gatimi bashkërisht, dalja për pazar ose orari i punëve të shtëpisë, gjumi në orare të caktuara, ...

Mbështeteni fëmijën që të organizojë ditët.

Përgatitni bashkë me fëmijën një "plan javor". Plani regjistron orarin dhe organizimin e kohës pasdite, fazat e detyrueshme dhe të kohës së lirë. Ai ju jep juve dhe fëmijës suaj një pasqyrë të ditës, duke përfshirë fushëveprimin e nevojshëm kohor.

Mendonit bashkë me fëmijën nëse është e nevojshme të bëni ndonjë ndryshim për javën e ardhshme (2 ose 4 javët e ardhshme), p.sh. sepse një lëndë mësimore kërkon një kohë më të gjatë

përgatitjeje ose shtohet një aktivitet i kohës së lirë.

Ndiqni ndryshimet në rutinat ditore nëse përshtaten apo jo dhe diskutojini me familjen.

Nxiteni fëmijën t'i bëjë detyrat e shtëpisë rregullisht në një kohë të caktuar. Në fund të ditës sigurohuni që fëmija i ka bërë të gjitha detyrat e shtëpisë për të nesërmen dhe i ka futur të gjitha mjetet e nevojshme shkollore në çantë. Strukturat e fiksuara, mbajtja e përgjegjësisë për detyrat e shtëpisë dhe materialet shkollore i japin fëmijës sigurinë dhe i forcojnë vetëbesimin.

Dakordimi për rregullat dhe pasojat

Fëmijës suaj duhet t'i bëhet e qartë se çfarë detyrash i përkasin në funksionin e tij si nxënës shkolle. Çfarë pret fëmija juaj kur nuk u përmbahet rregullave?

Orientimi drejt metodave të përdorura nga mësuesi për respektimin e vazhdueshëm të rregullave, për vlerësimet ose ndëshkimet mund t'ju ndihmojë.

Raporti i ecurisë së një nëne:

Për detyrat e pabëra të shtëpisë, fëmija merr fillimisht një sinjal jeshil nga mësuesi, pastaj një paralajmërim të verdhë dhe herën e tretë një shënim të kuq (me informacion nga prindërit plus sugjerimin për një diskutim prind-mësues). Meqenëse procedura e qëndrueshme me 3 hapa dëshmon sukses të kënaqshëm me fëmijën, atëherë këta prindër mund ta marrin "metodën me ngjyrat e semaforit" dhe ta përshtatin atë në edukimin në shtëpi. Prindërit menduan për një zbatim të përshtatshëm të metodës që i shpjeguan fëmijës:

- *kartoni jeshil nëse fëmija sillet në mënyrë të papranueshme (duke ia arsyetuar me fjalë),*
- *në rastin e parë të përsëritjes, kartonin e verdhë me perspektivën e "masës edukative" që pritet (e përshtatshme për situatën, tharja e enëve në atë që në të vërtetë është koha e lirë ose e ngjashme me të) dhe*
- *në rastin e dytë të përsëritjes kartonin e kuq me kërkesën e vazhdueshme për "masën edukative".*

Duhet mbajtur parasysh se: Shkollat në Gjermani nuk e shohin si detyrën e tyre kryesore edukimin e fëmijëve. Ai bazohet në prezumimin: Prindërit i rrisin fëmijët e tyre që të pranojnë rregullat e nevojshme për të mësuar dhe për të jetuar së bashku.

Për kujtesë: Marrëveshja e vazhdueshme mes mësuesve dhe prindërve për rregullat e nevojshme mund të bëhet në mbrëmjet e prindërve (takimi i kujdestarisë së klasës), në diskutimet prindër-mësues, gjatë orarit të konsultimit të prindërve ose në takime individuale. Modelet për kërkesat për intervistë mund të gjenden në www.wegweiser-bw.de.

Shkëmbimi me mësuesit e fëmijës

Flisni me mësuesin e fëmijës suaj për sugjerime dhe qasje rreth zbatimit të "këshillave". Kërkoni mbështetje në përpjekjet tuaja.